



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E lidhur me datën 27.09.2018 ne Lipjan ndërmjet:

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson drejtorit të Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit **N.SH "Avolite Mix", Prishtinë** të cilën e përfaqëson z. Shkumbin Krasniqi (në anën tjetër) në tekstin e mëtejshëm kontraktuesi.

Titulli i kontratës: Shërbimi me paisje teknike për manifestime dhe organizime të ndryshme për DRSK-në me numër Identifikues 613 018 070 236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Shërbimi me paisje teknike për manifestime dhe organizime të ndryshme për DRSK-në

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të kontratës, për një periudhë kohore prej 90 ditëve

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jenë: Territori i Komunës së Lipjanit

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm për kryerjen e shërbimeve me paisje teknike për manifestime dhe organizime të ndryshme për DRSK-në shprehur në shifra është **3420.00 €**; shprehur me fjalë, tremije e katerqind e njezet / Euro/e zero /cent/.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të bëhet pasi që menaxheri i kontratës të hartoj raport me shkrim për përfundimin e të gjitha shërbimeve së bashku me situacionin përfundimtar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të *realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë, kontrollojë gjat shërbimeve të kryera operatorin ekonomik, në mënyrë që të përcaktojë nëse shërbimet e paisjeve kanë cilësinë e kërkuar.

9.2 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në material. Kontraktuesi do të garantojë edhe se asnjë nga shërbimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shkumbin Krasniqi	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtori i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.09.2018	Data:	27.09.2018
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr.	PËRSHKRIMI PËR PJESËN TEKNIKE	Njesia	Sasia	çmimi për copë	Totali
Pjesa teknike për Manifestime dhe organizime					
SKENA / BINA					
1	Sherbimi-montimi i binës me 6x4m, bina duhet të jetë me prapaskene, mbuloje (kulem) cerade, duhet të ketë shkallët për hyrje dhe zbritje, e shtruar në tepison-tepi ngjyre e kuqe, 4 metra lartësi	Copë	2	300.00	600.00
2	Shërbim me zërim me fuqi > 10.000 w ≤ 40.000 w, me shpërndarje përveq bines edhe në 4 vende të bines, laptop, se paku 6 mikrofone, në laptop duhet të ketë dy Himnet, Kombëtar dhe Shtetror,	Copë	2	300.00	600.00
3	Shërbim me zërim me fuqi > 10.000 w, laptop, se paku 6 mikrofone, në laptop duhet të ketë dy Himnet, Kombëtar dhe Shtetror,	Copë	1	200.00	200.00
4	Shërbim me 40m` ribonë	m'	40	5.00	200.00
5	Furnizim me dy flamuj, një kombëtar ndërsa tjetri i Republikës së Kosovës me dimensione 2 x 1.5m, të jetë i përshtatshëm për vendosje në shtizë në lartësi vertikale	Copë	10	5.00	50.00
6	Shërbim me karrike, të jenë të një ngjyre	Copë	300	0.5	150.00
7	Furnizim me Flamuj kombëtar me shtizë me me përmasa 1.40x. 90 cm	Copë	100	5.00	500.00
8	Furnizim me Flamuj shtetror të Republikës së Kosovës me shtizë me me përmasa 1.40x. 90 cm	Copë	100	5.00	500.00
9	Furnizim me stema të Republikës së Kosovës (mostra do të ipet nga Dkrs)	Copë	16	10.00	160.00
10	Furnizim me stema të kombëtare (mostra do të ipet nga Dkrs)	Copë	16	10.00	160.00
11	Shërbim me kran (korp) për vendosjen dhe q`vendosjen e flamujve me rastin e festës së 28 nëntorit, në qytetin e Lipjanit,	Copë	1	120.00	120.00
12	Shërbim me kran (korp) vendosjen dhe q`vendosjen e simboleve apo dekorimeve tjera në sheshin "Adem Jashari"	Copë	1	120.00	120.00
13	Furnizim me 2 buqeta lulesh kualitative	Copë	2	20.00	40.00
14	Një kurorë me mbishkrimin Komuna e Lipjanit	Copë	1	20.00	20.00
Shuma e përgjithshme					3420.00